



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Mjek në Sektorin e Analizës, Monitorimit dhe Kostifikimit të Shërbimeve Spitalore pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo Shërbimi Civil për thyrje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Arsimin e lartë Mjekësi;
- Eksperiencë pune;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh; (dëshmi,çertifikata)
- Aftësi komunikuese dhe pune në grup;
- Njohuri bazë në kompjuter;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Fondit, brenda datës 08.11.2022, si më poshtë;

- Kërkesë me shkrim për t'u punësuar;
- Jetëshkrimi i plotësuar (CV);
- Diplomë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master;
- Listë notash;

- Dëshmi për kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Fotokopje e Librezës së Punës që vërtetojnë eksperiencën në punë;
- Çertifikatë Kompjuteri;
- Çertifikatë familjare;
- Fotokopje e kartës së identitetit (ID);
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë;

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa:

**Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Rruga “Sami Frashëri” nr.8,
Tel. +3554223815, E-mail: info@fsdksh.gov.al.**